



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primiçeno Më/Dana **09-07-2013**

Nr. i organit Org. broj	Num. i org. Prilog	Shtojor Prilog	Titull Urgjendës
01-013/551			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 28.06.2013, merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E MONUMENTIT PËRKUJTIMOR
PËR DËSHMORIN FLORIN MALIQI NË NGASTREN KADASTRALE 284-0 Z.K.
SADOVINË E ÇERKEZËVE

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, CAKTON lokacion për ndërtimin e monumentit (Lapidarit) përkujtimor për Dëshmorin Florin Maliqi i rënë në Betejën e Koshares për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb.

Neni 2

Vendi – lokacioni për ndërtimin e monumentit përkujtimor nga neni 1 i këtij vendimi caktohet në Z.K. Sadovinë e Çerkezëve, në anën e majtë të rrugës Sadovinë e Çerkezëve – Sllatinë, në ngastrën kadastrale nr.284-2 në pronësi të P.Sh. Komuna e Vitisë dhe ka një sipërfaqe prej 400 m² me dimensione të ofruara nga Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 3

Vendimi nga neni 1 i këtij Vendimi është miratuar nga Kuvendi i Komunës në bazë të propozimit të Drejtorisë për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi dhe kërkesës së Këshillit të fshatit Sadovinë e Çerkezëve me nr. 07/07/490 të datës 10.06.2013.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadastër
2. Këshillit të fshatit
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDI
Skenderbe Hebibi